


RAPORTI VJETOR 2016

Përgatitur për

MBLEDHJEN E IX-të TË KUVENDIT TË STIKK




01 Mars 2017
Ora 09:00 në **ICK**



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
Publikimet gjatë vitit 2016	5
Mbledhjet e bordit	5
Stafi i STIKK	5
Anëtarët e STIKK	5
Të hyrat dhe shpenzimet	5
Auditimi i financave të STIKK	5
AKTIVITETET	6
Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK.....	6
Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut	17
Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore	23
Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut	31
Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK.....	33
TË HYRAT DHE SHPENZIMET	34
Të hyrat	34
Shpenzimet	35
MBLEDHJET E BORDIT	36




Të hyra

Trajnime

21

STIKK EDUCATION



Anëtarët

B2B Takime

3
Irlandë, Gjermani,
KosICT

Grupe Punuese **12**



2016

Publikime

1



10 Konferenca
& Panaire
 **KOSICT**

Business
Leads

11

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjate periudhës së njëvjeçare të vitit 2016 janë realizuar aktivitete të cilat janë në përputhshmëri me pesë (5) objektivat e STIKK:

- **Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK**
- **Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut**
- **Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore**
- **Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut**
- **Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK**

Nën objektivin e parë të strategjisë së STIKK janë ndërmarr aktivitete të cilat mbështesin rritjen e sektorit të TIK. Disa nga aktivitetet me ndikim më të madh në saje të objektivës janë: Lansimi i Strategjisë Nacionale të TI-së, Parku i Biznesit dhe i Teknologjisë në Bërnice, fillimi i punës për koordinim të Strategjisë Kombëtare të TIK, Dita Mbarëkombëtare e TIK, Mengjesët me anëtarë dhe Programi për reformat në ekonomi nga Ministria e Financave.

Nën objektivin e dytë, zhvillimi i burimeve njerëzore ose zhvillimi i fuqisë punëtore në TIK është njëra prej shtyllave kryesore për një rritje të qëndrueshme të sektorit. Disa nga aktivitetet për këtë vit janë: Zhvillimi i aktiviteteve të bazuara në programin e trajnimeve STIKK Education dhe trajnime dhe punëtori për ngritje të kapaciteteve në bazë të projektit CBC.

Objektivi i tretë ku caku është krijimi dhe zhvillimi i mundësive biznesore për anëtarët duke fuqizuar dhe zgjeruar rrjetin biznesor të tyre. Disa prej aktivitete që mbështesin këtë objektivë janë: Festivali Teknologjik KosICT 2016, Punëtoritë për Export Promotion Service & Business Opportunities, B2B udhëtime në shtete Perendimore Evropiane, Java e Teknologjisë dhe Turizmit në Istog dhe Udhëtimi në Tajvan.

Objektivi i katërt ku krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme u mbështet nga këto aktivitete: Trajnimi për Menaxherët e Shoqatave përkrahese të biznesit në Vienë dhe aplikimi në programe të ndryshme për mbështetje të projekteve potenciale për sektorin e TIK.

Publikimet gjatë vitit 2016

- Studimi "IT Barometer Kosovo 2016":
http://stikk.org/fileadmin/user_upload/IT_Barometer_Kosovo-2016_eng.pdf

Mbledhjet e bordit

Gjatë vitit 2016 u mbajtën gjithsej gjashtë 4 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme të Bordit të STIKK (22 Janar, 23 Shkurt, 15 Mars, 12 Prill, 20 Prill, 14 Shtator dhe 7 Dhjetor).

Stafi i STIKK

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016, janë bërë disa ndryshime në stafin e STIKK:

Gjatë kësaj periudhe, Egzon Gashi është avancuar në pozitën e Menaxherit Junior të Projekteve nga data 01.01.2015. Gjatë kësaj periudhe, Nita Pallaska ka filluar praktikën nga data 15.02.2016. Nga STIKK vullnetarisht është larguar Mimoza Bardhi pas përfundimit të kontratës së punës me 01.06.2016. Hana Ahmeti ka filluar punës si Menaxhere e Administratës dhe Financave nga 01.07.2016, Fjolla Dubovci si Menaxhere Junior e Projekteve nga 15.02.2016. Nga data 08.04.2016, Nita Pallaska kaloi nga pozita e Praktikantes në Asistente e Administratës dhe Financave.

Anëtarët e STIKK

Gjatë këtij viti janë bërë **6** anëtarësime të reja të kompanive në STIKK: KosBIT, Zetta Technologies, COM ING, Imbus Peja, SAP dhe Alt3c, evroTarget dhe Microsoft Skopje DOOL (në nivelin e anëtareve bashkëpunues/Patron). **15** Kompani janë tërhequr nga anëtarësimi në STIKK në 2016: KosovoGuide, Dy Gur, PrimeDB, Red Mill, Elektring, Scards, PBC, TEKKOS, Next SEO, Rolling Rabbits, KaleMedia, S.P.I., VGN NET, Techland dhe SA electronic.

Në fund të vitit, STIKK ka në total **53** anëtarë (38 kompani anëtarë, 9 profesionist/student dhe 6 anëtarë bashkëpunues).

Të hyrat dhe shpenzimet

Gjatë vitit 2016, të hyrat e STIKK ishin **289,995.27 €** (22,76% më pak krahasuar me 375,471.00 € të vitit 2015), ndërsa shpenzimet kapin shumën prej **304,709.79 €** (50,33% më shumë krahasuar me 202,685.96 € në vitin 2015).

Auditimi i financave të STIKK

Kompania audituese e pavarur "Grant Thornton", e përzgjedhur nga anëtarët e STIKK në Mbledhjen e Kuvendit 2016, do të bëjë auditimin e të gjitha transaksioneve dhe procedurave financiare të STIKK për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor 2016. Ky auditim do të realizohet gjatë muajit Mars.

AKTIVITETET

Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK

27 Janar 2016

PROGRAMI FINAL I VLERESIMIT TË MSF II

Me datën 27 Janar, në zyret e STIKK erdhen përfaqësues të programit MFSII për të vlerësuar rrjedhën e projektit që STIKK kishte në partneritet me organizatën Holandeze SPARK. Si metodë e vlerësimit ishte intervista, ku përfaqësuesit u njoftuan nga afër me zhvillimet, të mirat e projektit, pengesat dhe vështirësit për ndërmarrësit tanë në Kosovë. Në intervistim ishte z. Ermal Sadiku nga LinkPlus IT, z. Kushtrim Sogojeva nga Trokit dhe z. Lorik Mullaademi nga STIKK.

Përfaqësuesit e programit u ndanë të kënaqur me rrjedhën e programit dhe projektit, si dhe rezultatet e arritura gjate ketij projekti pesëvjeçar.

11 Shkurt 2016

IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË SË SIGURISË KIBERNETIKE

Me datën 11 shkurt, STIKK u përfaqësua nga zt. Lorik Mullaademi në takimin për implementimin e strategjisë kibernetike të Kosovës. Strategjia vetëm se ishte miratuar në procedura të shpejta nga Qeveria e Kosovës dhe ishte udhëhequr nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në kuadër të këtij takimi u shtjellua nga partnerët në implementim aktivitetet që do të punohen në kuadër të strategjisë, ku partnerët implementues treguan arritjet e tyre në 3-mujorin e parë. Në këtë takim gjithashtu u pajtua që të raportohet çdo tre-mujor për risitë në implementim.

17 Mars 2016

TAKIMI I GRUPIT LOKAL KËSHILLËDHËNËS (LAG)

Më 17 Mars 2016 u mbajt takimi i Grupit Lokal Këshillëdhënës (LAG) për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Partner i rregullt në konsultim ishte dhe STIKK. Në këtë takim, u diskutua për rrjedhjen e ligjeve në përpikëmbëri me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për shoqëri civile, e cila synon që të përmisojë ambientin e punës për organizata jo qeveritare dhe vullnetarë.

29 Janar 2016

FILLON PUNA PËR KOORDINIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË TIK

Me datën 29.01.2016, STIKK së bashku me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik filluan punën për koordinim e Strategjisë Kombëtare të TIK-ut, e cila u aprovua me datën 30.12.2015 nga Qeveria e Kosovës. Prezent në takim dhe pjesë e komitetit do të jenë akteret me të rendësishëm të zhvillimit të teknologjisë në Kosovë, duke përfshirë këtu bizneset private të TIK, STIKK, ICK, Qeverinë e Kosovës dhe donatorët, duke përfshirë këtu kontribuesit më të medhenj për zhvillimin e strategjisë, Ambasaden Norvegjeze të Kosovës e cila po përfaqësohet nga shkelqësia e tij, Ambasadori Jan Braathu, dhe GIZ me përfaqësuesen znj. Elena Lau.



24 Mars 2016

KUVENDI I VIII-TË I STIKK

Mbledhjen e filloi kryetari i Bordit, z. Shkumbin Brestovci, i cili i informoi të pranishmit që pjesëmarrja e tij në këtë mbledhje është vetëm për t'i njoftuar për dorëheqjen nga cilësia e Kryetarit të Bordit të STIKK dhe njëkohësisht të tërheqjes së anëtarësimit të kompanisë së tij nga STIKK.

Z. Shkumbin Brestovci theksoi që arsyeja deri të ky vendim ka ardhur për shkak të përshtypjeve të tij që STIKK-u nuk është më shoqate e cila i përfaqëson anetarët e saj, por është shëndërruar në Think Tank. Në vazhdim, z. Brestovci i informoi të pranishmit që këto dhe disa çështje të tjera siç janë vendimi i anetarëve të Bordit për largimin e z. Altin Ukshinit nga bordi i STIKK me arsyetimin se nuk i permbush kushtet sipas Statutit, Çështja e përzgjedhjes së Cactusit për furnizimin fillestar të ICK në vitin 2012; çështja e mosraportimit të të deleguarve të STIKK në Bordin e ICK dhe çështje të tjera që janë prezantuar dhe diskutuar në mbledhjet e fundit të bordit, mirëpo edhe për shkak të mungesës së vullnetit dhe mospërkrahjes nga ana e anëtarëve të tjerë të bordit, vjen deri te një vendim i tillë.

Tutje diskutimin e vazhdoi z. Enver Doko, i cili fillimisht theksoi që është shume e çuditshme dhënia e dorëheqjes për shkak të mungesës së informatave nga viti 2012 kur dihet se z. Brestovci ka qenë pjesë e bordit të STIKK, gjithashtu një vendim i tillë për hir të korrektësisë është dashur fillimisht të diskutohet dhe t'ju prezantohet anëtarëve të tjerë të bordit, njëkohësisht, për shkak të obligimit të bordit për të mbikëqyrë në mënyrë të veçantë zyrën ekzekutive të STIKK, është dashur të kërkohen të gjitha informatat e nevojshme për të zgjidhur të gjitha çështjet e ngritura dhe të krijohet një raport me këto informata dhe t'i prezantohet Kuvendit dhe jo në këtë formë. Permeteper, Mbledhja e Kuvendit është akt solemn dhe detyrat e Kuvendit janë të paracaktuara me Statut, rrjedhimisht nuk duhet të mirret me çështje të brendshme të Bordit.

Pas këtij diskutimi, z. Brestovci largohet nga salla.

Diskutimin e vazhdoi z. Dardan Vokshi, nënkryetari i bordit të STIKK, i cili fillimisht falënderon z. Brestovci për kontributin e dhënë deri më tani në STIKK për zhvillimin e këtij sektori, gjithashtu fton të pranishmit të diskutojnë rreth çështjes së hapur nga z. Brestovci.

Në vazhdim të gjithë anëtarët e Bordit të STIKK njëzëri theksuan që çështjet e ngritura nga z. Brestovci janë diskutuar në mbledhjet e bordit, mirëpo deri më tani asnjëri nga anëtarët e bordit nuk ka arritur në një përfundim të tillë sikurse edhe z. Brestovci, gjithashtu që është për tu çuditur fakti që nuk ka pasur kërkesa nga vetë z. Brestovci për tu takuar më shpesh bordi për vazhduar diskutimin në fjalë, përkundrazi ka qenë shumë e theksuar neglizhimi i tij rreth permbushjes së shumë obligimeve me rëndësi dhe tendenca për të bllokuar shume procese dhe aktivitete të STIKK.

Z. Driton Hapciu, tha se arsyeja pse jemi në këtë pike është për shkak se kemi një diverzitet të përvojave të ndryshme në fushë si dhe në mënyrën e të menduarit, poashtu besoj që në momentin që kemi mospajtime duhet të diskutohen deri në gjetjen e zgjidhjes adekuate. Duke e marr parasysh që unë jam njeri nga anëtarët e bordit që ka dhënë dorëheqje në të kaluarën, kjo nuk më ka ndaluar që të vazhdojë të llojë për zhvillim sa më adekuat të sektorit dhe të STIKK, duke qenë pjesë e komiteteve apo takimeve të ndryshme. Permeteper, çështja e ngritur nga Z. Brestovci rreth furnizimit të ICK me pajisje fillestare nuk ka baze, pasi që kete tenderim e ka kryer kompania norvegjeze në pajtim me procedurat e veta.

Në vazhdim, z. Vokshi, propozoj rendin e ditës:

Rendi i ditës:

1. Hapja e Kuvendit

Shkumbin Brestovci, Kryetar i Bordit të STIKK

2. Prezantimi i raporteve vjetore të shoqatës

Shkumbin Brestovci, Kryetar i Bordit të STIKK - Aktivitetet ndërkombëtare të shoqatës dhe Aktivitetet e Bordit të STIKK

Vjollca Çavolli, Drejtoreshë Ekzekutive në STIKK - Aktivitetet vjetore të shoqatës

3. Aprovimi i agjendës së punës, Formimi i kryesisë së punës, komisionit punues për numërimin e votave dhe procesverbal-mbajtësit

Shkumbin Brestovci, Kryetar i Bordit

4. Diskutimi dhe aprovimi i raportit vjetor të STIKK

Shkumbin Brestovci, Kryetar i Bordit

5. Prezantimi i planit të punës dhe buxhetit për 2016

Mentor Sahiti, Anëtar i Bordit

6. Diskutime, sugjerime dhe aprovimi i planit të punës dhe buxhetit për 2016

7. Nominimi dhe votimi i anëtarëve të rinj të Bordit Ekzekutiv dhe përzgjedhja e Auditorit për tre vitet e ardhshme

Anëtarë i Bordit

8. Prezantimi i rezultateve të votimit

Komisioni punues për numërim të votave

9. Të tjera dhe përmbyllja

1. Aprovimi i agjendës së punës, Formimi i kryesisë së punës, komisionit punues për numërimin e votave dhe procesverbal-mbajtësit

Pasi që nuk pati propozime për pika shtesë në rendin e dites, Kuvendi mori:

VENDIM: Aprovohet rendi i ditës.

Sa i përket komisionit për Kryesi të punës u zgjodhën në baza vullnetare si në vijim:

- 1. Dardan Vokshi**
- 2. Enver Doko**
- 3. Mentor Sahiti**

Komisioni punues për numërimin e votave dhe procesverbal mbajtësi u zgjodhen si në vijim:

- 1. Fjolla Cavolli**
- 2. Enver Doko**
- 3. Shkumbin Hoxha**

Ndërsa procesverbal mbajtëse ishte znj. Njomza Uka Selimi nga stafi i STIKK.

2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit vjetor të STIKK

Ne këtë pike z. Vokshi fton për diskutim të hapur rreth raportit vjetor të STIKK.

Z. Mentor Sahiti, kërkoi informata shtesë rreth fondit inovativ për shkak që deri më tani ka qenë vetëm një aktivitet medial nga ana e qeverisë. Znj. Vjollca Cavolli iu përgjegj se nuk ka më shumë informata për këtë iniciativë.

Pas këtij propozimi z. Vokshi propozoi votimin e raportit vjetor për vitin 2015 të cilin znj. Cavolli kishte prezantuar më parë. Me këtë rast anëtarët e Kuvendit morën vendim:

VENDIM: Aprovohet unanimisht raporti vjetor.

3. Prezantimi i planit të punës dhe buxhetit për 2016

Plani i punës dhe buxhetit për vitin 2016 u prezantua nga z. Mentor Sahiti i cili tha se plani i punës për vitin 2016 është përgatitur në përputhshmëri me strategjinë nacionale të TIK. Sipas z. Sahiti plani është mjaft ambicioz dhe duke marrë parasysh që të gjitha këto aktivitete varen nga komuniteti i donatoreve.

z. Sahiti theksoi se aktivitetet janë të ndara në objektiva dhe secili prej aktiviteteve ka indikatorin e suksesit dhe buxhetin e specifikuar.

Ne këtë rast mund të shihni se në objektivin e parë: Krijimi i një mjedisi të favorshëm legjislativ dhe politik për zhvillim të përshpejtuar të sektorit të TIK-ut ka disa aktivitete ndër to është Avokimi për TIK si sektor me përparësi për zhvillim ekonomik, gjithashtu është shumë me rëndësi që të kemi sa më shumë komunikim

të rregullt me institucionet e Kosovës dhe palët e tjera. Me këtë rast z. Sahiti i përmendi të gjitha aktivitetet e këtij objekti dhe i cilësoi të gjitha si mjaft të rëndësishme.

Për objektivin e dytë z. Sahiti tha se burimet njerëzore janë pasuria më e madhe e sektorit të TIK ku duhet ta pranojmë se në këtë pikë ekziston një hapësirë boshë në mes të fuqisë punëtore të cilën e prodhon Universiteti dhe kërkesave reale të kompanive. Në këtë pikë është me rëndësi të theksohet që STIKK-u është duke u munduar që ta plotësoj atë hapësirë nëpërmjet trajnimeve të STIKK Education ku ka për qëllim të trajnoj 90 pjesëmarrës me shpresë që kompanive anëtarë të saj t'ju lehtësoj sadopak këtë problem.

Me tutje z. Sahiti vazhdoi me objektiven e tretë të planit të punës duke bërë të ditur se ky objektivi ka për qëllim ndihmën e dhënë kompanive anëtare dhe dhënien e mundësisë së rritjes dhe zhvillimit të tyre si dhe krijimin e bashkëpunimit me vendet e zhvilluara në mënyrë të veçantë nëpërmjet Business Leads të cilat dërgohen nga STIKK. Gjithashtu, hulumtimi IT Barometer është shumë me rëndësi për gjithë sektorin pasi që është një matje e tregut të TIK në raport me rajonin. Gjithashtu, theksoi edhe organizimin e konferencës KOSICT e cila tani më është tradicionale, ndërsa ajo çka është risi është organizimi i ngjarjeve B2B me sektorët tjerë.

Objektivi i katërt i cili është Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut u cilësua si një prej më të rëndësishmeve duke marrë parasysh se rezultati i aktiviteteve të STIKK dhe anëtarëve duhet të jetë që STIKK në të ardhmen të jetë e vetqëndrueshme edhe pa ndihmën e donatoreve mirëpo vetëm me anëtarësinë e saj.

Ndërsa objektivi i fundit i planit të punës ka të bëjë me mbështetjen e anëtarëve për ushtrimin e përgjegjësisë shoqërore të sektorit të TIK-ut në të cilën bëhet vetëm organizimi i dhënies vullnetare të gjakut e cila tani më është bërë tradicionale. Në këtë pikë duhet të punohet me shumë rreth promovimit të aktiviteteve bamirëse të anëtarëve të shoqatës.

4. Diskutime, sugjerime dhe aprovimi i planit të punës dhe buxhetit për 2016

Pas prezantimit të planit të punës dhe diskutimeve, z. Vokshi propozoi votimin e planit të punës për vitin 2016. Me këtë rast, anëtarët e kuvendit morën vendim:

VENDIM: Aprovohet plani i punës, ndërsa kishte një abstenim (Z. Driton Hapciu).

5. Nominimi dhe votimi i anëtarëve të rinj të Bordit Ekzekutiv

Në këtë pikë, z. Dardan Vokshi, nënkryetar i bordit, njoftoi të pranishmit lidhur me situatën aktuale të Bordit, ku me skadimin e mandatit të 4 anëtarëve ekzistues si dhe shkarkimit të një anëtari gjatë vitit, poashtu edhe të dorëheqjes së sotme të kryetarit të Bordit, mungesës pa arsye të një anëtari, anëtarët prezent të Bordit janë pajtuar që me marrëveshje xhentëllmëne t'i propozohet Kuvendit shkarkimi i Bordit në përgjithësi, e cila gjë edhe u aprovua.

Në vazhdim, z. Vokshi i ftoi pjesëmarrësit e mbledhjes të propozonin dhe të votonin për anëtarët e rinj të bordit, përfshirë këtu edhe nominimet online që janë bërë para mbledhjes së Kuvendit.

Nominimet janë dhëne ne vijim:

1. **Mentor Sahiti** (Adaptivit)
2. **Dardan Vokshi** (INET)
3. **Arben Ymeraga** (Melita&Partners)
4. **Vigan Budima** (Asseco SEE)
5. **Leutrim Blakaj** (Zetta Technologies)
6. **Ermal Sadiku** (LinkPlut IT)
7. **Hysen Demiri** (Ilir Kosova)
8. **Zana Tabaku** (Appdec)
9. **Ilir Gorani** (AVC Group)
10. **Argjent Nela** (ITEG)
11. **Korab Zhuja** (PrimeDB)
12. **Naim Berisha** (MikroBiz)
13. **Driton Hapçiu** (Cacttus)
14. **Florent Sllamniku** (KosBIT)

Votimi i anëtarëve u bë me lista të hapura, me votim të fshehtë. Votuan gjithsej 25 anëtarë.

Anëtarët e rinj të Bordit Drejtues të STIKK në bazë të votave të anëtarëve janë:

1. **Mentor Sahiti (Adaptivit) 21 Vota**
2. **Dardan Vokshi (INET) 19 Vota**
3. **Vigan Budima (Asseco SEE) 18 Vota**
4. **Leutrim Blakaj (Zetta Technologies) 15 Vota**
5. **Ermal Sadiku (LinkPlus IT) 15 Vota**
6. **Zana Tabaku (Appdec) 14 Vota**
7. **Arben Ymeraga (Melita&Partners) 13 Vota**
8. **Ilir Gorani (AVC Group) 12 Vota**
9. **Argjent Nela (ITEG) 11 Vota**
10. **Korab Zhuja (PrimeDB) 10 Vota**
11. **Naim Berisha (MikroBiz) 9 Vota**
12. **Driton Hapciu (Cacttus) 7 Vota**
13. **Florent Sllamniku (KosBIT) 7 Vota**
14. **Hysen Demiri (Ilir Kosova) 7 Vota**

Në vazhdim, anëtarët e bordit ne mënyrë unanime vendosen që kryetari i bordit të jetë z. **Mentor Sahiti**, ndërsa nën kryetar z. **Dardan Vokshi**.

Në të njëjtën kohë dhe në bazë të Statutit, u votua edhe për kompaninë e auditimit të STIKK. Pesë ofertat ishin:

1. **Baker Tilly 4,425.00 €**
2. **Balluku & Zhavelli 3,894.00 €**
3. **Grant Thornton 3,396.00 €**
4. **Deloitte 5,310.00 €**
5. **Audit Group 5,800.00 €**

ndërsa votat e dhëna janë si në vijim:

1. **Grant Thornton 3,396.00 € (8 Vota)**
2. Baker Tilly 4,425.00 € (7 Vota)
3. Balluku & Zhaveli 3,894.00 € (5 Vota)
4. Deloitte 5,310.00 € (5 Vota)
5. Audit Group 5,800.00 € (0 Vota)

Në bazë të votave të mbledhura, kompania e cila do të bëjë auditimin e STIKK në tri vitet e ardhshme është **Grant Thornton**.

6. Të tjera dhe Përmbyllja

Nën të ndryshme, z. Driton Hapçiu përmendi edhe njëherë pakënaqësitë e tij rreth rrjedhes se Kuvendit të mbajtur sot e poashtu vlen e njehta edhe me Kuvendin e vitit të kaluar. Gjithashtu shprehu pakënaqësitë lidhur me projektin STIKK Education, duke kërkuar evitimin e konfliktit të interesit.

Gjithashtu, nën të ndryshme z. Enver Doko, propozoi që Bordi i ri të merr si obligim primar që së bashku me zyrën ekzekutive të STIKK të bëjë një ndarje se cilat obligime mund t'i mbulojnë së bashku, dhe në mënyrë eksplicite të takohen më të gjitha kompanitë anëtare dhe jo anëtare, dhe të miren me çështje të tjera. Gjithashtu është shumë me rendësi që STIKK në mënyrë të veçantë të mundohet t'i mënjanojë të gjitha mundësitë e konfliktit të interesit me kompanitë anëtare të saj.

Mbledhja e tetë e Kuvendit të anëtarëve të STIKK u përmbyll nga Kryetari i ri i Bordit të STIKK, z. Mentor Sahiti i cili në mënyrë të veçantë falënderoi pjesëmarrësit për prezencën dhe për kontributin e tyre në mbledhjen e kuvendit të STIKK.

4 Maj 2016

MËNGJESI ME ANËTARË DHE MINISTRIN E ZHVILLIMIT EKONOMIK, ZT. BLERAND STAVILECI

Më 4 Maj 2016, STIKK organizoi edicionin e parë të Mëngjesit me Anëtarë, ku i ftuar ishte Ministri i Zhvillimit Ekonomik, zt. Blerand Stavileci dhe present ishin drejtor ekzekutiv si dhe menaxher nga kompanitë e TIK-ut.

Ky takim jo-formal ngriti tema të ndryshme në bashkëbisedim me Ministrin Stavileci, ku u theksuan tema sikur Fondi i Inovacionit, Strategjia Kombëtare e TIK-ut, si dhe politika të zhvillimit afatgjatë.

Ministri Stavileci theksoi dy ide me të cilat STIKKu dhe kompanitë anëtare mund të kontribuojnë në promovimin e sektorit; 1. si fillim u ceken takime më të shpeshta në baza javore në të cilat mund të përfshihen mediumet dhe portalet vendore; 2. emisionet teknologjike të jenë me tematika më të fokusuara për zhvillimet në vend.

Anëtarët tanë ngritën çështjen e ndihmës së zbehtë nga ana e Qeverisë në përkrahjen e kompanive të TIK-ut në përfaqësim në ngjarje rajonale dhe ndërkombëtare sikurse Cebit, Appsworld, Webit etj., të cilat kanë potencial për të sjell investime në ekonominë e vendit; Bashkëpunim më i mirëfilltë midis Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Diasporës, Punëve të Jashtme dhe të tjerave; Një lidhje më e mirë midis kompanive vendore, diasporës dhe personave të kyçur në industrinë e TIK-ut në vende të zhvilluara.

Gjithashtu u diskutua tema e edukimit formal si dhe incentivat nga ana e Qeverisë për bursa mujore për trajnimin e kandidatëve të rinj në kompani. Në fund u diskutua që sektori i TIK-ut mund të jetë më fitimprurës në një kohë më të gjatë në krahasim me sektoret tjerë.

Kjo ngjarje u sponsorizua nga kompania e shërbimeve të TIK-ut, LinkPlus IT (www.linkplus-it.com)



18 Maj 2016

MËNGJESI ME ANËTARË DHE KOSTT

Në edicionin e dytë të Mëngjesit me Anëtarë, i ftuar ishte z. Nagip Syla nga kompania KOSTT ku bisedoi mundësive të bashkëpunimit me kompanitë anëtare të STIKK. Pjesëmarrës ishin edhe kompanitë anëtare të STIKK ku biseduan rreth sfidave dhe mundësive që mund të shërbejnë në përmirësimin e kushteve për sektorin e TIK.



21 Qershor 2016

KONFERENCA NACIONALE PËR PROGRAMIN E EKONOMISË DIGJITALE TË KOSOVËS (KODE)

Përfaqësues të STIKK ishin të pranishëm në hapjen e Konferencës Nationale për programin e ekonomisë digjitale të Kosovës (KODE) të organizuar nga Grupi i Bankës Botërore.

KODE nisi ditën e parë me fjalët hyrëse të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik zt. Blerand Stavileci, i cili në fjalët hyrëse tha që e ardhmja e ekonomisë së Kosovës duhet të shihet kah fusha e teknologjisë informative dhe ajo që ka arritur kulmin në këtë aspekt është programi i ekonomisë digjitale.

I pranishëm në konferencë ishte edhe Ministri i Financave zt. Avdullah Hoti, i cili tha se vitin e kaluar pjesë të pakos fiskale ka qenë lirimi prej TVSh-së të pajisjeve të teknologjisë si pjesë e zhvillimit të këtij sektori.

27 Qershor 2016

LANSIMI I STRATEGJISË NACIONALE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, STIKK bëri lansimin e Strategjisë Nationale të Teknologjisë së Informacionit. Kjo është një nga iniciativat më të mëdha dhe më fitimprurëse për sektorin e TIK, si dhe zhvillimin socio-ekonomik në Kosovë.



Në këtë ngjarje fjalimet hyrëse u bënë nga Z. Blerand Stavileci - Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Z. Isa Mustafa - Kryeministër i Republikës së Kosovës, Z. Jan Braathu - Ambasador i Ambasadës Norvegjeze në Kosovë, Znj. Henriette Kötter - Përfaqësuese e Ambasadës Gjermane në Kosovë. Ndërsa prezantimi i Strategjisë Nationale të TI u bë nga Z. Agim Kukaj nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Z. Lucas von Zallinger - Konsulent për GIZ.

Paneli u moderua nga Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, znj. Vjollca Çavolli, dhe pjesëmarrës në të ishin Z. Blerand Stavileci - Ministër i Zhvillimit Ekonomik, znj. Anila Statovci - Zëvendës Ministre e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Z. Ramadan Ilazi - Zv. Ministër i Integritimit Evropian, Z. Mentor Sahiti - Kryetar i Bordit Ekzekutiv të STIKK, dhe Natalija Gelvanovska - Senior ICT Policy specialist at The World Bank.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa ka thënë se Qeveria e Kosovës, është e përkushtuar të krijojë të gjitha mundësitë që të aplikohet revolucion i digjital, duke inkurajuar transformimin digjital të bizneseve ekzistuese dhe përkrahjen e më shumë bizneseve digjitale në vend, ndërsa ka theksuar se zhvillimi ekonomik i Kosovës është i bazuar në dije.

30 Qershor 2016

DITA MBARËKOMBËTARE E TIK

Vazhdon tradita e Ditës Mbarëkombëtare të TIK me edicionin e 8-të, ku kompanitë nga Kosova dhe Shqipëria u takuan dhe shkëmbyen praktikatat dhe eksperiencat e fundit.

Gjithashtu, gjatë ditës u prezantuan gjetjet e barometrit të TI për dy vendet për vitin 2016, të cilat shpejt do të publikohet në faqet e organizatës sonë dhe AITA.



27 Shtator 2016

MËNGJESI ME ANËTARË TË STIKK DHE KOMPANITË ANËTARE TË ODËS EKONOMIKE GJERMANO-KOSOVARE

Mëngjesi me kompanitë anëtare të STIKK dhe kompanitë anëtare të OEGJK u hap nga Kryetari i Bordit të STIKK z. Mentor Sahiti dhe Drejtori Ekzekutiv i OEGJK, z. Albert Matoshi.



Në këtë takim ishin prezent kompanitë anëtare të STIKK dhe kompanitë anëtare të OEGJK, ku u trajtuan temat mbi bashkëpunime potenciale dhe zhvillimin e sektorit të IT-së. Për më shumë, u bisedua rreth krijimit të më shumë mundësive në eksportin e shërbimeve kosovare në tregun internacional me fokus në Gjermani, dhe krijimin e një sistemi me procedura më të përshtatshëm për eksportim. Ky sistem do të ndikonte në rritjen e efikasitetit të shërbimeve të eksportuara sepse do të lejonte kompanitë të kenë një formë të automatizuar përmes së cilës do të operojnë më shpejt dhe do të jenë më të qasshme në treg.

Poashtu, u theksua se OEGJK do të punoj në priorizimin e sektorit të IT-së në mënyrë që partneriteti të jetë më i qëndrueshëm. Ky partneritet krijon edhe rritje të punësimit, faktor i cili ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e ekonomisë në përgjithësi.

21 Dhjetor 2016

PARKU TEKNOLOGJIK I BIZNESIT NË BËRNICË

**BT Park Prishtina***Founded by* **STIKK**

Pas thirrjes për shprehjen e interesit të shpallur nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), STIKK konsideroi që kjo të jetë një hapsirë potenciale në zhvillim më të qëndrueshëm të sektorit të TIK dhe aplikoi në këtë thirrje. Brenda 30 ditëve, u aprovua vendimi që STIKK të ketë në menaxhim Parkun Teknologjik të Biznesit në Bërnice.

Parku Teknologjik i Biznesit në Bërnice do të krijoj hapësirë për kompanitë e TIK në mënyrë të krijimit të bashkëpunimeve më të përshtatshme dhe më të aftërta në mes kompanive dhe start-upeve lokale, ndërkombëtare dhe investitorëve.

Gjatë kësaj kohe është duke u punuar në finalizimin dhe nënshkrimin e kontratës.

27 Dhjetor 2016

PREZANTIMI I PROGRAMIT PËR REFORMAT NË EKONOMI NGA MINISTRIA E FINANCEVE

Në këtë takim, ministri Avdullah Hoti, në cilësinë e Koordinatorit Nacional për hartimin e dokumentit 'Programi për Reforma në Ekonomi (PRE)', si pjesë e dialogut për politika ekonomike ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës, bëri të ditur se procesi i përpilimit të ERP-it të sivjetmë është duke u zhvilluar brenda kornizave të parapara kohore dhe dinamika e punëve të deritashme është duke u zhvilluar konform udhëzimeve të Komisionit Evropian. Pjesë e takimit ishte edhe znj. Vjollca Çavolli.

Gjatë këtij takimi, nga anëtarët e komisionit u dhanë komente dhe sugjerime të ndryshme, të cilat do të kontribuojnë në përpilimin e draftit final të ERP 2017-2019. Në këtë takim përfaqësuesi i Zyrës për Planifikim Strategjik, prezantoi 20 masat e prioritizuara që janë mjaft gjithëpërfshirëse dhe përmbajnë të dhëna të shumta për potencialin e madh ekonomik të Kosovës.



Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut

14 Janar 2016

MBAHET TAKIMI I DYTË I KOMITETIT KËSHILLËDHËNËS TË STIKK EDUCATION

Komiteti Këshillëdhënës i projektit të STIKK Education është takuar për herë të dytë me 14 Janar, 2016, në zyret e STIKK. Ky Komitet, i cili përbëhet nga përfaqësues anëtarë të STIKK, ka për qëllim të ndihmojë në zhvillimin e programit të trajnimeve dhe të sigurojë së përgatitja e përfituesve të i përshtatet nevojave të kompanive të TIK në Kosovë.

Tre profilet e STIKK Education do të jenë:

- Menaxhment i TI-së
- Zhvillim Softuerik
- Zhvillim i Aplikacioneve Mobil

Eksperti i jashtëm i angazhuar nga STIKK dhe Komiteti janë duke punuar në kurrikulat të cilat do të përdoren për të adresuar në mënyrë specifike barrierat lidhur me zhvillimin e shkathtësive dhe trajnimit. Vizioni i kësaj iniciative është të ngrisë kapacitetet lokale në sektorin e TIK përmes trajnimeve kompetente profesionale, të disejuara enkas për të përmbushur nevojat e industrisë vendore, duke qenë në hap me trendet teknologjike ndërkombëtare.

STIKK Education do të ketë dy cikle trajnimi dhe aktivitete tjera shtesë të parapara në planin e mëposhtëm për një periudhë 12 mujore gjatë vitit 2016. Përmes trajnimeve, entuziastet e rinj do të fitojnë shkathtësi specifike që aktualisht janë shumë të kërkuara në tregun e Bashkësisë Evropiane duke zotëruar kurrikulën plotësisht, e cila është në përputhshmëri me Kornizën Evropiane për e-Kompetenca 3.0, që është një iniciativë e palëve të shumta të interesit nga sektori i TIK të Evropës në mënyrë që të identifikohen dhe standardizohen aftësitë të cilat momentalisht janë të nevojshme për tregun dhe e cila është bërë prioritet për implementim nga kompanitë lokale të TIK.

Gjithashtu, këta 90 të rinj entuziast në TI do të përfundojnë programin e praktikës në kompani anëtare të STIKK përmes shërbimit të STIKK për ofrimin e praktikës, gjë që do të ndihmonte në praktikimin e aftësive të sapo fituara nga trajnimet, si dhe do ta rrisë punësueshmërinë e tyre.



17 Mars 2016

HAPJA E APLIKIMIT PËR GJENERATËN E PARË TË STIKK EDUCATION



Hapja e aplikimit për gjeneratën e parë të STIKK Education filloi më 17 Mars, ku deri më tani kanë aplikuar 137 të interesuar.

Gjatë kësaj periudhe, STIKK pati rastin të bëjë prezantimin e trajnimeve dhe kurseve përmbajtëse në Fakultetin e Inxhinierisë në Prishtinë në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës së Universitetit të Prishtinës, para Akademisë për Karrierë të Kolegjit Universum.


Gjenerata e parë është paraparë të pranoj 45 të rinj gjithsej, duke ndarë 15 individë për secilin nga kurset: Menaxhment i TI-së, Zhvillim Mobil, Inxhinieri Softuerike. Trajnimi do të zgjasë gjashtë muaj, duke përfshirë tre muaj punë praktike në njërin nga kompanitë anëtare të STIKK.

Pas trajnimit në STIKK Education, pritet që këta të rinjë të jenë profesionalisht të përgatitur për tregun e punës së TIK.

10 Maj 2016

TESTIMI I APLIKANTËVE PËR STIKK EDUCATION

Më 10 Maj 2016, u zhvillua testimi për aplikantët e kurseve të STIKK Education, ku pjesëmarrës në testim ishin 117 kandidatë për të plotësuar 45 pozitat e ofruara.



16 Maj 2016

PREZANTIMI I PROJEKTIT CBC NË TIRANË

Stafi i STIKK, z. Bardh Kadiu dhe z. Lorik Mullaademi ishin pjesë në konferencën Java e Inovacionit në Tiranë, ku patën rastin të bisedojnë rreth Ekosistemit të Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit dhe Ekosistemit Inovativ.

Poashtu, është bërë prezantimi i projektit të financuar nga BE, "Zhvillimi i inovacionit dhe ndërmarrësisë në rajonin ndërkufitar të Kosovës dhe Malit të Zi, programi CBC Kosovë-Mali i Zi", ku u shpjegua qëllimi i projektit, përfituesit afat-gjatë të projektit, si dhe aktivitetet e projektit. Projekti parashihet të ketë rezultate premtuese për zhvillimin e shoqërisë kosovare në teknologji, si dhe ekonomisë në përgjithësi.



7 Qershor 2016

PJESËMARRJA NË PUNËTORINË PËR NGRITJEN E KAPACITETIT PËR ZYRTARËT E KOMUNAVE/QENDRAVE INFORMATIVE NË BERANE DHE ISTOG



Stafi i STIKK, z. Lorik Mullaademi dhe znj. Fjolla Dubovci ishin pjesë e punëtorisë për ngritjen e kapacitetit për zyrtarët e komunave/qendrave informative në Berane dhe Istog.

Punëtorja u mbajt në Berane, ku prezent ishin më shumë se 20 pjesëmarrës dhe përfaqësues së Shtëpisë së Inovacionit në Istog dhe Berane.

1 Korrik 2016

FILLIMI I TRAJNIMEVE TË STIKK EDUCATION

STIKK Education filloi trajnimin e parë të profilit Zhvillim Mobil. Me pjesëmarrje në trajnimin e parë na nderuan edhe Ambasadori Norvegjez në Kosovë, z. Jan Braathu si mysafirë të veçantë.

Gjatë javës STIKK Education vazhdoi me trajnimet edhe në fushat tjera të IT Menaxhment, dhe Inxhinieri Softuerike.



7 Shtator 2016

REGJISTRIMET E GRUPIT TË DYTË TË STIKK EDUCATION

STIKK Education vazhdon trajnimin në profilet Zhvillim Mobil, IT Menaxhment, dhe Inxhinieri Softuerike. Është bërë edhe regjistrimi i grupit të dytë të STIKK Education. Sa i përket grupit të parë është duke vazhduar trajnimi në profilet përkatëse, dhe përgatitja e studentëve në angazhimin për punë praktike në kompanitë anëtare të STIKK.

7 Korrik 2016

LANSIMI I PROJEKTIT TË CBC ISTOG-BERANE



Më 7 Korrik 2016, u bë lansimi i projektit "Zhvillimi i inovacionit dhe ndërmarrësisë në rajonin ndërkufitar të Kosovës dhe Malit të Zi, programi CBC Kosovë-Mali i Zi", i financuar nga Bashkimi Evropian, ku për herë të parë në Kosovë morri pjesë kryetari i Komunës së Berane, z. Dragoslav Scekcic, dhe Kryetari i Komunës së Istogut, z. Haki Rugova.

Lansimi i projektit u mbajt në Pallatin e Kulturës në Istog, përkatësisht në Shtëpinë e Inovacionit. Pas fjalimeve hyrëse, mysafirët dhe të gjithë pjesëmarrësit patën rastin të bisedojnë dhe hulumtojnë për bashkëpunime potenciale me njëri-tjetrin.

Shtëpia e Inovacionit në Istog do të shërbej si hapësirë bashkë-punuese për të gjithë të rinjtë e rrafshit të Dukagjinit, në mbështetjen e ideve inovative duke u bazuar në zhvillimin e sektorit të turizmit në teknologji. Në Shtëpinë e Inovacionit pritet të mbahen trajnime dhe punëtori për tema specifike të cilat do të përgatisin këta të rinjë në fusha specifike. Poashtu, hapësirat bashkëpunuese do të mund të përdorën edhe nga OJQ të cilat synojnë zhvillimin e gjendjes socio-ekonomike përmes trajnimeve dhe punësive.

26 Shtator 2016

TAKIMI I DYTË I KOMITETIT KËSHILLDHËNËS PËR PROJEKTIN E CBC



Në takimin e Komitetit Këshilldhënës u diskutuan hapat e parë të projektit, ku ishin të përfshirë prezantimet në shkolla të mesme të rrafshit të Dukagjinit me qëllim të njoftimit të objektivave të projektit; vizita studimore ne Val Di Fassa; aktivitetet e Shtëpisë së Inovacionit si trajnimet dhe punëtoritë në Istog dhe Berane, të cilat përgatisin të rinjtë të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit të turizmit përmes përdorimit të teknologjisë, dhe të njejtën kohë të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë.

Tetor-Dhjetor 2016

PRAKTIKA PROFESIONALE PËR GRUPIN E PARË E STIKK EDUCATION

Nga Tetori 2016, STIKK Education filloi me periudhën e praktikës për pjesëmarrësit e grupit të parë. Të gjitha kompanitë anëtare të STIKK ishin të informuara rreth procedurave të programit të praktikës, me aplikacionet e pjesëmarrësve dhe disa rezultate të cilat janë arritur nga pjesëmarrësit përgjatë periudhës së trajnimeve intensive (117 sesione për 45 pjesëmarrës të 3 profileve). Në sajë të kësaj, pjesëmarrësve u janë krijuar profile me informata të nevojshme për kompanitë, siç është kërkuar edhe nga vet kompanitë.

Nga 45 pjesëmarrës total të grupit të parë, 16 kanë zgjedhur të mos vazhdojnë me praktikë në kompani, për arsye të vazhdimit të studimeve dhe/ose arsye private. Nga 29 pjesëmarrës të mbetur, 16 kanë filluar praktiken. 13 pjesëmarrës të mbetur, të cilët kryesisht ishin nga profili IT Management, nuk kishin mundësi të zhvillojnë praktiken gjatë kësaj periudhe, meqenëse kompanitë nuk shprehën interes që të ofrojnë vende praktike për këta pjesëmarrës.

Dhjetor 2016

PËRZGJEDHJA DHE FILLIMI I TRAJNIMEVE PËR GRUPIN E DYTË

STIKK Education ka pranuar 196 aplikacione për grupin e dytë, 35% të të cilëve ishin të gjinisë femërore. Me 9 Dhjetor është mbajtur testi pranues, i cili përmbante pyetje nga këto kategori:

- Bazat e TI-së;
- Gjuha Angleze;
- Logjikë dhe Matematikë;
- Programim.

Duke konsideruar numrin e ulët të aplikacioneve në rundin e dytë për profilin e IT Management (11 në total) dhe interesin e ulët të kompanive të pranojnë në praktikë pjesëmarrës të këtij profili nga grupi i parë, ne kemi sugjeruar që të anulohet këtij profil për grupin e dytë.

Trajnimet intensive për profilet Mobile Development dhe Software Engineering për grupin e dytë do të fillojnë në mesin e Janarit, 2017.



Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore

16 Shkurt 2016

NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR SHTËPINË E INOVACIONIT NË ISTOG

Së bashku me nën-kryetarin e Komunës së Istogut, z. Lulzim Blakaj, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK) dhe Syri i Vizionit (SiV) nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit të Martën (16.02.2016) për projektin “Zhvillimi i inovacionit dhe ndërmarrësisë në rajonin ndërkufitar të Kosovës dhe Malit të Zi, programi CBC Kosovë-Mali i Zi”. Me këtë Memorandum të Mirëkuptimit u konfirmua hapësira punuese e implementimit të aktiviteteve.

Projekti ka për qëllim të fokusohet në zhvillimin dhe digjitalizimin e bizneseve turistike. Rrjedhimisht, ky projekt do të krijoj mundësi për të rinjtë, bizneset dhe ndërmarrësit të avancojnë produktet/shërbimet e tyre.

18 Shkurt 2016

PREZANTIMI I PROJEKTIT TË CBC NË BALKANS AND BLACK SEA ICT CLUSTERS NË BEOGRAD

Balkans and Black Sea ICT Clusters bashkon partnerët regjional të cilët veprojnë në fusha të ndryshme të TIK-ut, ku rrit mundësitë për bashkëpunim. Rrjedhimisht, stafi i STIKK pati rastin të shpjegoj qëllimet e projektit më specifikisht. Andaj, pjesëmarrja e STIKK në Balkans and Black Sea ICT Clusters potencon influencë pozitive dhe afatgjatë.

18 Mars 2016

ZHVILLIMI I TAKIMIT TË PARË KËSHILLËDHËNËS NË BERANE

Grupi i partnerëve nga Kosova u përbë nga Lorik Mullaademi, menaxher i projektit STIKK; Dukagjin Nishiqi, menaxher i projektit SiV; Arta Fetahu, zyrtarë për projekte Komuna e Istogut; Genci Ademaj, shef i kabinetit të kryetarit Komuna e Istogut; si dhe Syzana Baja, koordinatore për programe Solidar Suisse. Ndërsa nga ana e Malit të Zi, present ishin Predrag Scekcic, menaxher i projektit ToB; Aleksandar Prelevic, president ITCM; Nebojsa Babovic, Komuna e Beranës; Aleksandar Mijovic, Komuna e Beranës; Aleksandra Scepanovic, mësuese. Gjatë takimit, partnerët kanë diskutuar rreth procesit të punës në të dy shtetet, ku të dy palët kanë arritur të njoftohen nga afër dhe të adresojnë pikat kyçe të projektit.

Pikat e diskutuara përfshijnë progreset e bëra nga partnerët në Kosovë dhe në Mal të Zi. Partnerët biseduan rreth sfidave potenciale të paraqitura, dhe ideve të reja në implementimin e suksesshëm të projektit.

20 Janar 2016

TAKIM ME INVESTITORË TË ITALISË

Me datën 20 Janar, përfaqësues nga një kompani italiane të specializuar për siguri kibernetike ishin prezent në zyret tona për të diskutuar përreth sektorit të TIK në Kosovë, resurset vendore të kompanive tona, burimet njerzore si dhe mënyrat e bashkëpunimit. STIKK i shpjegoi për shërbimin e “Export Promotion Service”, i cili ndihmon kompanitë e huaja të punojnë me ato të Kosovës. Përfaqësuesit e kompanisë kanë mbetur për të dërguar formën e B2B Lead për bashkëpunim.

18 Mars 2016

PUNËTORIA #2: STIKK EXPORT PROMOTION SERVICE & BUSINESS OPPORTUNITIES

Me datën 18.03.2016 u mbajt punëtorja numër 3 për STIKK Export Promotion Service & Business Opportunities. Kjo punëtori u mbajt nga konsulenti Lucas von Zallinger dhe pjesëmarrës ishin kompani të TIK dhe STIKK.

Punëtorja përfshiu një pasqyre të tregut të IT-së dhe trendëve të fundit të teknologjisë në shtetët DACH (Gjermani, Austri dhe Zvicër), si dhe një diskutim mbi "Business Leads" dhe mundësi të biznes bërjes në fushën e eksportit në Gjermani, Britani të Madhe dhe Itali.

*6 Qershor 2016*

TAKIM ME EKIPIN E BANKËS BOTËRORE DHE KOMPANITË ANËTARE TË STIKK



Më 6 Qershor 2016 u mbajt takimi me ekipin e Bankës Botërore ku u diskutua përmirësimi i Konkurrueshmërisë dhe Vendeve të punë në sektorin e TIK në Kosovë, së bashku me Innovation Centre Kosovo dhe kompanitë anëtare të STIKK.

1 Korrik 2016

PUNËTORIA E 4-TË PËR SHËRBIMIN E PROMOVIMIT TË EKSPORTIT DHE MUNDËSIVE BIZNESORE


U mbajt punëtorja e katërt për shërbimin e Promovimit të Eksportit dhe Mundësive Biznesore, e cila është një nga iniciativat e STIKK e përkrahur nga GIZ. Moderator i kësaj punëtorie ishte Lucas von Zallinger.



6-7 Tetor 2016

B2B UDHËTIMI NË IRLANDË

Kjo ngjarje ndër-rajonale bëri bashkë institucione dhe kompani nga sektori i TIK nga Irlanda, Irlanda Veriore, Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, si dhe Gjeorgjia dhe Moldova si mysafire, në mënyrë që të eksplorojnë bashkëpunimet biznesore. Përfitimet kyçe ishin bashkëpunimi dhe zhvillimi i lidhjeve të reja biznesore (B2B dhe B2G), duke përfshirë ndërmarrjet e përbashkëta, konzorciume, zhvillimin e përbashkët të produkteve, duke eksploruar mundësitë e bashkëpunimit për projekte përmes Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFI), ndërkombëtarizimit, të mësuarit në lidhje me tregjet e reja dhe promovimin e eksportit dhe vetëdijes.



28-30 Tetor 2016

FESTIVALI TEKNOLOGJIK - KOSICT 2016

Me 28 dhe 29 Tetor 2016, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) në partneritet me Innovation Centre Kosovo (ICK) dhe Kolegjin Universum organizuan KosICT 2016 me moto "Festivali Global i Teknologjisë" i cili u mbajt në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Rrjedhimisht, temat e mbuluara në KosICT16 ishin: Startups and Funding, Digital Marketing, Big Data, edTech, dhe Esports. Konferenca mundësoi sesione paralele të prezantimeve dhe paneleve në dy Salla, të Kuqen dhe të Kaltërtën, të specifikuara sipas temave.

Mu për këtë, pjesëmarrësit nga sektori i biznesit të përbërë nga drejtorët, zhvilluesit biznesor dhe investitorët, patën rastin të jenë pjesë e sesioneve relevante në bazë të interesit të tyre. Temat e shtjelluara në sallën e Kuqe ishin: E ardhmja e ekosistemit të start-up dhe financimit të tyre; Rëndësia e Big Data në përmirësimin e jetës së përditshme; Si e transformon teknologjia sektorin e edukimit; Si po e bën Digjital Marketing zëvendësimin e mediave tradicionale.

Ndërsa, në sallën e Kaltërt u mbuluan temat: Trendet më të reja të investimeve në teknologji; Zhvillimi i sporteve elektronike (eSports) nga podrumet deri te arenat ndërkombëtare. Diskutimet në panel ishin një mundësi involvimi për të dyja palët: folësit dhe audiencën. Folësit patën debate, diskutime dhe komunikim me audiencën duke i shpalosur këndvështrimet e tyre në secilën temë.

Gjatë dy ditëve të konferencës, pjesëmarrës ishin 26 folës nga kompanitë më të njohura botërore si Google, LinkedIn, Entrepreneurs Mag, Capgemini, Rimac Automobili, Angel Labs dhe të tjera. Për më tepër, aktivitetet shtesë në KosICT 2016 ishin panairi i Outsourcing dhe Startup kompanive, kampionati në eSports i cili u mbajt në teatrin ODA më 29 dhe 30 tetor, netët tematike të KosICT nights në 5 kafeteritë më të popullarizuara të Prishtinës, si dhe follow up biznesor.

Numri i pjesëmarrësë gjatë dy ditëve të konferencës KosICT'16 kaloi shifrën prej 1700 personave.



Startup dhe Outsourcing Panairi

Startup dhe Outsourcing panairi ishte një nga pikat kryesore i gjithë Festivalit të Teknologjisë. Gjatë dy ditëve, përfaqësuesit e startups treguan përkushtimin dhe interesimin e tyre drejt ndryshimeve pozitive si dhe ndërmarrësisë. Këta ndërmarrës të rinj vazhdimisht prezantuan idetë e tyre inovative para investitorëve, folësve, engjujve të biznesit dhe pjesëmarrësve të tjerë.

Përveç kohës së rrjetëzimit gjatë pauzave dhe mësimëve nga Salla e Kuqe dhe Kaltërt, ata patën mundësinë për ta treguar angazhimin dhe perspektivën e tyre drejt trendeve aktuale të teknologjisë.

Pjesëmarrës në panairin Startup dhe Outsourcing ishin: Formon, Solaborate, Platforma Akademia, Anketa, Gjurmët, SumtheSun, devICE, ValorLab, Architecture for Humans, eGothix, RavenBit, jCoders, ZAG Apps dhe Mikrobiz.

Të gjithë startups patën mundësinë të prezantojnë produktet/shërbimet e tyre para 400 investitorëve, bizneseve, CEO's. Si rezultat, u mbajtën më shumë se 150 takime me investitorët potencial, ku patën mundësinë të flasin në detaje lidhur me ofertat e tyre. Përveç kësaj, disa nga këta ndërmarrës të rinj patën fatin të fitojnë disa investimeve nga vizitorët gjatë konferencës.



KosICT eSports Kampionati në CS:GO



Entuziastët e eSports kaluan vikendin e tyre më 29 dhe 30 Tetor 2016 në Teatrin Oda duke shikuar Kampionatin e Esports në CS:GO. Duke marrë parasysh ndikimin e kohës digjitale është duke pasur në përditshmërinë e të gjithëve, eSports njihet të jetë fusha më atraktive për të gjitha gjeneratat. Sidoqoftë, lojërat nuk konsiderohen vetëm për argëtim; lojërat janë bërë indikator të rritjes së ekonomisë së shteteve në përgjithësi.

Duke u bazuar në ndikimin pozitiv të cilin eSports ka në botë, të gjitha shtetet janë duke u fokusuar të lidhin Esports me fusha specifike si edukim për shembull, në mënyrë të transferojnë idetë e ndërmarrësisë në biznes përmes përdorimit të teknologjisë dhe eSports.

Kështu, në mënyrë të qasjes në fushën e eSports si ide biznesi në aspekte të ndryshme, KosICT 2016 organizoi Kampionatin CS:GO ku inicioi qmimin fitues prej 1,000.00 Euro për ekipen fituese. Një javë para Kampionatit CS:GO, u zhvillua gara me te gjitha ekipet e interesuara. Pjesë e garës ishin 16 ekipe nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

Më 29 Tetor 2016, ekipet që garuan në semi-finale ishin: LevelOne kundër KosovaFive dhe GAMEZONE kundër ekipit Prishtina. Ekipet fituese, LevelOne dhe GAMEZONE vazhduan në Kampionatin CS:GO më 30 Tetor 2016.

Fituesit e Kampionatit CS:GO, LevelOne ishin fitues të 1,000.00 Euro; kurse vendi i dytë u shpërblye me bileta të shohin IEM Katowice.

Gjatë Kampionatit CS:GO, më 29 dhe 30 Tetor, 2016, më shumë se 400 persona vizituan Teatrin Oda të pecjellin lojën. Për më shumë, ata të cilët nuk mundën të vizitojnë Teatrin Oda, e përcjellën përmes transmetimit direkt. Kështu, Kampionati CS:GO arriti 20,000 shikime në transmetimin direkt.

KosICT Nights

Për të bërë Festivalin e Teknologjisë edhe më tërheqës dhe të plotë, KosICT ka mbajtur ngjarje edhe mbrëmjeve ku pjesëmarrësit dhe të gjithë të tjerët do të takoheshim me folësit tanë personalisht në bare të ndryshme të Prishtinës dhe për të diskutuar rreth temave të KosICT.

Çdo bar kishte folës që mbulojnë tema specifike të KosICT, ku pyetje, përgjigje dhe biseda të rehatshme janë përpunuar. Temat u shpërndanë në bazë të bare e poshtëshënuar: Marketingu Digjital në Morena; Startup & Financimi në Soma Book Station; Të Dhënat Masive në Bamboo Bar; eSports në MIQT Pub; dhe edTech në Dit 'e Nat'. Në natën e dytë, ne kishim edicionin FuckUp Night KosICT, si pjesë e konferencës, ku disa nga folësit tanë ndanë me publikun përvojat personale në lidhje me dështimet e tyre dhe se si ata arritën të kthehet në rrugën e duhur.

Pas fjalimeve të folësit, u jap liri audiencës t'u shtroj pyetje folësve, kështuqë seanca të bëhej sa më shumë interaktive dhe kushdo mund të marrë pjesë ose të japin mendimin e tyre. Befasia e Netëve të KosICT ishte ngjarja në Morena Bar, ku KosICT solli DJ të njohur nga Belgjika vetëm për mysafirët tanë. Kjo ishte një ngjarje e paharrueshme, ku mbi 300 pjesëmarrës kanë shijuar muzikë të mirë dhe njëkohësisht edhe rrjetëzim. Të gjithë pjesëmarrësit kaluan kohën e tyre gjatë ngjarjes duke folur me njëri-tjetrin në një mënyrë më të afërt dhe miqësore, e cila lejoji ata të jenë më të rehatshëm në ndarjen e ideve të tyre dhe krijimin e kontakteve si referenca të ardhshme.



14-18 Nëntor 2016

B2B UDHËTIMI NË GJERMANI

STIKK, në bashkëpunim me Capgemini Consulting dhe me përkrahjen e GIZ dhe USAID, organizoi një B2B udhëtim në Gjermani nga 14 deri me 18 Nëntor 2016. Gjashtë kompani anëtare të STIKK (Adaptivit Engineering, Cactus, ITEG, LinkPlus, Rrota dhe Zetta Technologies) patën rastin të takohen me kompani dhe organizata të rajonit të Cologne, Frankfurt dhe Darmstadt, të cilat punojnë në fushën e Teknologjisë së Informacionit.



14-19 Nëntor 2016

JAVA E TEKNOLOGJISË DHE TURIZMIT NË ISTOG



Hapja e Javës së Inovacionit për Teknologji dhe Turizëm në Shtëpinë e Inovacionit në Istog u bë me 14 Nëntor 2016 dhe zgjati deri më 19 Nëntor 2016. Numri i pjesëmarrësve të Javës së Inovacionit për Teknologji dhe Turizëm ishte 53 të rinjë, prej të cilëve 20 ishin nga Mali i Zi.

Gjatë kësaj jave të rinjtë u mentoruan nga ekspertë të fushës së turizmit dhe TIK, ndërsa të shtunën më 19 Nëntor u prezentuan idetë më të mira para jurisë profesionale. Ishte e paraparë që idetë më inovative të shpërblehen me shumën deri në 3,000.00 Euro për zhvillim të mëtutjeshëm, nga të cilat 9,000 Euro u siguruan nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Gjatë ditës u prezantuan 15 grupe të ndryshme me idetë e tyre biznesore me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik duke nxitur inovacionin & sipërmarrjen në industrinë e turizmit. Vlerësimi i ideve biznesore është bërë nga juria e pavarur dhe profesionale, të përbërë nga ekspertët e fushës për Teknologji dhe Turizëm, ku nga 15 biznes propozime janë përzgjedhur 10 idetë me të mira, duke përfutur nga 3,000 euro secila ide.

12-18 Dhjetor 2016

UDHËTIMI NË TAJVAN

Idea e vizitës në Taipei ka qenë në lidhje me përkrahjen e Tajvanit rreth mundësive për përkrahjen e STIKK Education. Anëtarët e bordit të STIKK, të cilët njëkohësisht përbëjnë edhe Komitetin Këshillëdhënës të STIKK Education, së bashku me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe STIKK ishin prezent në këto takime. Për më shumë, u bisedua rreth mundësive të bashkëpunimit ku mund të pritët nga Tajvani përkrahja përmes bursave për studentë dhe organizimi i punëtorive për ndonjë temë të përshtatshme.



Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut

14 Mars 2016

STIKK APLIKON NË PROGRAMIN E DSP TË KCSF-SË

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), me përkrahje të Zyres Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA), ofron përkrahje financiare për projekte dhe organizata përmes projektit për Promovim të Shoqërisë Demokratike (DSP). Objektivi i parë i DSP-së është ndihmesa e shoqërisë civile në avokim dhe lobim, në kuader të së cilës edhe STIKK aplikoi për Grant Institucional me 14 Mars. Përzgjedhja pritët të bëhet deri në fund të Qershorit.

16 Mars 2016

PËRGATITJE E MENAXHIMIT MË TË MIRË TË MARRËDHËNIES ME ANËTARË

Në mënyrë që të ofrohet një eksperiencë më e mirë për anëtarët, STIKK, me ndihmën të konsulentit z. Lucas von Zallinger, përgatiti një plan për zhvillim e një Customer Relationship Management (CRM) platforme. Janë marr parasysh disa shembuj të platformave ekzistuese, ndërsa më e preferuara është cilësuar Salesforce, me të cilën është duke u negociuar mundësia e ofromit falas të shërbimeve për STIKK.

29 Qershor 2016

STIKK APLIKON NË HAPJEN E PROJEKTIT TË BASHKIMIT EVROPIAN “EUROPEAN INSTRUMENT FOR DEMOCRACY AND HUMAN RIGHTS CBSS FOR KOSOVO”

STIKK në bashkëpunim me organizatën Lens dhe Peer Educators Network (PEN) aplikoj në programin “European Instrument for Democracy and Human Rights CBSS for Kosovo”, me idenë e projektit “Promoting ICT as Basic Human Right and Tool for Active Engagement of Youth”.

19 Shtator 2016

STIKK APLIKON NË ENGAGEMENT FOR EQUITY PROGRAM (E4E) - ATRC

STIKK aplikon në Engagement for Equity Program (E4E) në fushën Women in Governance and Economy me idenë “Promoting minority women’s professional development through digital skills”.

6-11 Nëntor 2016

TRAJNIM PËR MENAXHERËT E SHOQATAVE PËRKRAHESE TË BIZNESIT NË VIENË

Qëllimi i këtij seminari ishte të sigurojë menaxherët e lartë me aftësi dhe njohuri që mundësojnë më shumë njohuri efektive për të menaxhuar organizatat e tyre. Përqëndrimi ishte në çështjet thelbësore organizative dhe operative për promovimin e tregtisë, të tilla si ndikimin e ndryshimit të biznesit, udhëheqjen dhe menaxhimin, definimin e strategjisë dhe zbatimin, duke kuptuar kulturën e korporatës, rëndësinë e komunikimit dhe ndërtimin e ekipeve të forta. Të ftuar nga STIKK në këtë trajnim ishin znj. Vjollca Çavolli dhe z. Bardh Kadiu.



Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK

Mars 2016

MBËSHTETJA E PROJEKTIT ROBOTIKS

RobotiKS është kamp edukativ i organizuar çdo vit duke përdorur logjikën dhe aftësitë kreative të fëmijëve për të krijuar robot të thjeshtë. Në kuadër të programit për përgjegjësi sociale të kompanive anëtare të STIKK ftojë kompanitë anëtare që të kontribuojnë në projektin e RobotiKS, i cili këtë vit po organizohet nga IPKO Foundation. Projekti ofron fëmijëve të moshave të reja për të programuar LEGO robotë, të cilat do të organizohen gjatë kampit RobotiKS është mbajtur në Qershor 2016 dhe do mbulohej nga të gjitha mediat publike të Kosovës dhe rrjetet sociale të organizatave të përfshira në organizim. Këtë vit, projekti është përkrahur nga anëtarët përmes:

- Dhurimit të laptopëve të cilët do të shfrytëzohen për programimin e LEGO robotëve. Të njëjtit mund të përdoren në vazhdimësi në realizimin e RobotiKS në të ardhmen; dhe
- Dhurata për fëmijët të tilla si USB, tableta, apo pajisje tjera të vogla teknologjike që mund t'i hyjnë në përdorim fëmijëve/shkollave pjesëmarrëse, me brendin e kompanisë suaj.

17 Maj dhe 12 Tetor, 2016

DHURIMI I GJAKUT

Këtë vit u organizua 3 herë aksioni për dhurim të gjakut. Në ambientet e ICK-së janë mbajtur aksionet e dhurimit të gjakut, aksione të cilat tashmë janë bërë traditë e shoqatës sonë. Dhuruesit kanë qenë nga STIKK, ICK, përfaqësues të kompanive anëtare të STIKK, ekipet e inkubatorit të ICK-së, si dhe njerëz të tjerë që nuk janë pjesë e qendrës.

Aksioni i dhurimit të gjakut u mbajt në zonën "Events Area", ku në dispozicion ishin 4 shtretër që së bashku me pajisjet tjera përcjellëse u siguruan nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.



TË HYRAT DHE SHPENZIMET

Të hyrat

Gjatë vitit 2016, të hyrat e STIKK ishin **289,995.27 €** (22,76% më pak krahasuar me 375,471.00 € të vitit 2015) dhe atë nga 5 burime të mjeteve: Programi i BE-së Cross-Border Cooperation, Microsoft, Ambasada Norvegjeze, GIZ dhe Anëtarët e STIKK (anëtarësia, participimi në trajnime dhe aktivitete tjera). Detajet e të hyrave janë të prezantuara në tabelën në vazhdim:

		B2B	CBC	Microsoft	Norwegian Embassy	SPARK 2015	Kos ICT	STIKK	GIZ	TOTAL
Ordinary Income/Expense										
	Income									
	Total Income									
	Other Income	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	270,00	0,00	270,00
	Training Fees	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	9.001,75	0,00	9.001,75
	47200 - Program Income	4.527,60	197.343,50	910,69	34.993,68	-10,46	35.698,50	-44.325,72	41.195,73	270.333,52
	47230 - Membership Fees	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	10.390,00	0,00	10.390,00
	Total Total Income	4.527,60	197.343,50	910,69	34.993,68	-10,46	35.698,50	-24.663,97	41.195,73	289.995,27
	Total Income	4.527,60	197.343,50	910,69	34.993,68	-10,46	35.698,50	-24.663,97	41.195,73	289.995,27

Shpenzimet

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet e STIKK arritën shumën prej **304,709.79 €** (67% më shumë krahasuar me 202,685.96 € në vitin 2015). Disa nga projektet nuk janë mbyllur këtë fundvit, pasi që edhe kontratat, por edhe kohëzgjatja është e ndryshme. Pasqyra e shpenzimeve në detaje është e prezantuar në tabelën në vazhdim:

		B2B	CBC	Microsoft	Norwegian Embassy	SPARK 2015	Kos ICT	STIKK	GIZ	TOTAL
Ordinary Income/Expense										
	Gross Profit	4.527,60	197.343,50	910,69	34.993,68	-10,46	35.698,50	-24.663,97	41.195,73	289.995,27
	Expense									
	Humbjet nga ushtrimi i veprimt.	0,00	0,00	0,00	609,76	0,00	1.085,20	0,00	0,00	1.694,96
	Indirect Cost	0,00	84,07	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	84,07
	Local and Regional travel	0,00	967,75	0,00	0,00	0,00	0,00	450,06	0,00	1.417,81
	Meetings	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	1.242,33	0,00	1.242,33
	Other Expenses	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	451,38	0,00	451,38
	Presentation & Event expenses	0,00	25.093,22	0,00	427,00	0,00	6.052,02	312,67	45,73	31.930,64
	Professional Services	0,00	5.500,00	675,00	0,00	0,00	0,00	1.115,60	17.667,95	24.958,55
	Program Activities	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	20.155,00	0,00	0,00	20.155,00
	Shpenzimet e partnereve	0,00	51.782,67	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	51.782,67
	Training & Event expenses	0,00	1.980,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	1.980,00
	62800 - Facilities and Equipment	0,00	2.558,20	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	9.000,00	11.558,20
	65000 - Admin Costs/Operations	0,00	4.444,43	0,00	827,63	0,00	1.704,77	9.817,21	0,00	16.794,04
	66000 - Salary long term Local Staff									
	Executive Director	0,00	0,00	0,00	2.400,00	0,00	0,00	23.504,19	0,00	25.904,19
	Finance Officer	0,00	5.997,72	0,00	1.280,00	0,00	0,00	4.657,00	0,00	11.934,72
	Finance Officer -Assistant	0,00	2.945,72	0,00	0,00	0,00	0,00	380,61	0,00	3.326,33
	Health Insurance	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	2.508,00	0,00	2.508,00
	Intern	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	287,50	0,00	287,50
	Junior Project Manager	0,00	0,00	0,00	4.410,00	0,00	0,00	1.296,87	0,00	5.706,87
	Member relations Coordinator	0,00	10.775,28	0,00	0,00	0,00	0,00	2.633,16	0,00	13.408,44
	Programme Manager	0,00	0,00	0,00	11.520,00	0,00	0,00	7.783,20	0,00	19.303,20
	Project Manager CBC	0,00	14.339,17	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	14.339,17
	Training Coordinator STA	0,00	0,00	0,00	5.040,00	0,00	0,00	2.143,72	0,00	7.183,72
	Total 66000 - Salary long term Local Staff	0,00	34.057,89	0,00	24.650,00	0,00	0,00	45.194,25	0,00	103.902,14
	68300 - International travel & transp.	3.621,50	29.202,80	0,00	0,00	0,00	1.935,33	1.998,37	0,00	36.758,00
	Total Expense	3.621,50	155.671,03	675,00	26.514,39	0,00	30.932,32	60.581,87	26.713,68	304.709,79

MBLEDHJET E BORDIT

Gjatë vitit 2016 u mbajtën gjithsej **gjashtë** mbledhje të Bordit të STIKK (4 të rregullta, 2 të jashtëzakonshme).

Mbledhja katërdhjetë e dy: 22 Janar 2016 (e rregullt)

Mbledhja është vendosur të mbahet si video konferencë në pajtueshmëri me Statutin e STIKK (neni 7.5.4), mirpo ka vazhduar ne forme fizike per shkaqe teknike.

Pikat e rendit te ditës te cilat u diskutuan gjate kësaj mbledhjeje:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e katërdhjetë (e rregullt) mbajtur më 16 Shtator 2015;
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor (Korrik-Shtator) të STIKK;
3. Diskutim dhe aprovim i raportit tremujor (Tetor-Dhjetor) të STIKK;
4. Diskutim dhe aprovim i raportit vjetor 2015;
5. Diskutim rreth çështjeve ligjore te bordit te STIKK (përgjigjet nga znj. Iliriana Serreqi);
6. Organizimi i Kuvendit 2015;
7. Të ndryshme.

Vendimet:

- Miratuan unanimisht Procesverbalin e mbledhjes se katërdhjetë te Bordit te STIKK;
- Aprovohet raporti 3 mujor i STIKK;
- Te dërgohen pyetësorët për hulumtimet e ardhshme paraprakisht për komente dhe sugjerime tek bordi;
- Aprovohet raporti 3 mujor i STIKK;
- Te dërgohet email për mundësi pjesëmarrjeje ne komitetin këshillëdhënës për STIKK Education tek anëtarët;
- Miratuan unanimisht raportin vjetor te STIKK;
- Miratohen unanimisht te gjitha përgjigjet nga znj. Serreqi;
- Kryetari i Bordit z. Shkumbin Brestovci, (respektivisht Bordi i STIKK) te kontaktoj z. Altin Ukshini rreth vendimit te marrur me dt. 22 Janar 2016;
- Kryetari i Bordit z. Shkumbin Brestovci, (respektivisht Bordi i STIKK) te kontaktoj z. Ardall Celina rreth gatishmërisë se tij per qene pjese e bordit të STIKK;
- Miratohet unanimisht qe mbledhja vjetore te mbahet me dt 17 Mars.

Mbledhja katërdhjetë e tre: 23 Shkurt 2016 (e jashtëzakonshme)

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:

- 1. Diskutim rreth çështjeve të propozuara nga kryetari i Bordit të STIKK z. Shkumbin Brestovci:**
 - Mënyrën se si janë caktu deri tash përfaqësuesit e STIKK-ut në bordin e ICK-së,
 - Mënyrën se si janë caktu pjesëmarrësit në bordin këshilldhanës të STIKK Education,
 - Si janë prokuru furnizimet në ICK,
 - Si janë prokuru furnizimet në STIKK,
 - Mungesa e vullnetit të stafit të zyres së STIKKut për me i mirëmbajtje kontaktet me antarët e vet, ndonëse kjo ka qenë kërkesë eksplicite në shumë mbledhje të bordit;
- 2. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e katërdhjetë e dyte (e rregullt) mbajtur më 19 Janar 2016;**
- 3. Organizimi i Kuvendit të 8-të të STIKK:**
 - Caktimi i lokacionit,
 - Votimi dhe përzgjedhja e anëtarëve të rinj të Bordit,
 - Shpërndarja e përgjegjësiave anëtarëve të Bordit për mbledhjen e Kuvendit Vjetor;
- 4. Diskutim rreth kontratës së Drejtoreshës Ekzekutive të STIKK e cila mbaron më 31 Mars 2016;**
- 5. Të ndryshme.**

Vendimet:

- Vendoset që të dërgohen obligimet e STIKK ndaj ICK ne baze te Statutit te ICK
- Vendoset që të dërgohen procedurat ne baze te STUTIT te ICK përzgjedhja e bordit te ICK;
- Vendoset që komiteti këshillëdhënës i STIKK Edukation te suspendohet deri ne mbledhjen e ardhshëm të bordit të STIKK;
- Vendoset që zyra ekzekutive te përgatitë një liste me propozimet për komitetin këshillëdhënës te STIKK Edukation;
- Te krijohet dhe dërgohet lista e furnitorëve dhe vlerave te ICK nga fillimi i funksionimit;
- Te krijohet dhe dërgohet lista e furnitorëve te STIKK nga fillimi i funksionimit;
- Vendoset te përgatitet një raport/liste ne baze te statutit dhe manualit te bordit lidhur me delegimet nga bordi tek zyra ekzekutive rreth aktiviteteve/veprimeve te bëra deri me tani pa involivimin e bordit;
- Te përgatitet një manual/udhëzim apo çfarëdo dokumenti te shkruar lidhur me përgjegjësitë dhe obligimet e nënshkruesit financiar;
- Për shkak te largimit te z. Shkumbin Brestovci për arsye shëndetësore vendoset që diskutimi lidhur me këtë pikte te rendit te ditës te diskutohet ne një takim te ardhshëm te bordit;
- Miratuan unanimisht Procesverbalin e mbledhjes se katërdhjetë e dyte (e rregullt) te Bordit te STIKK;
- Vendoset që mbledhja vjetore e Kuvendit te mbahet me 24 Mars 2016;
- Vendoset që te kërkohen 3 oferta lidhur me lokacionin e organizmit te mbledhjes;
- Vendoset që të dërgohen tek bordit Burimet e mjeteve dhe Plani i punës për inpute shtese ne afat prej 7 ditëve;
- Vendoset që z. Mentor Sahiti te beje prezantimin e planit te punës dhe burimeve te mjeteve;
- Mbledhja vjetore te mbahet vetëm me anëtarët e STIKK;
- Vendoset te përgatitet një raport lidhur me ecurinë e deritanishme te DE znj. Vjollca Cavolli;
- Te dërgohet formulari i vlerësimit te punës për znj. Cavolli;
- Vendoset që kryetar i Bordit z. Shkumbin Brestovci se bashku me DE znj. Vjollca Cavolli, te kontaktoj z. Ardall Celina për te qene pjese e bordit te STIKK, njëkohësisht te i kërkohet edhe permbushja e obligimit te pagesës se anëtarësisë ne STIKK;
- Të përpilohet një vendim lidhur me arsyetimet e shkarkimit te z. Altin Ukshini dhe te dërgohet tek anëtarët.

Mbledhja katërdhjetë e katër: 15 Mars 2016 (e jashtëzakonshme)

Kjo mbledhje është mbajtur pa prezencën e drejtoreshës ekzekutive Znj. Vjollca Çavolli.

1. Diskutim rreth kurrikulave dhe Komitetit Këshilldhënës të STIKK Education

Në lidhje me kurrikulat e STIKK Education, anëtarët kishin vërejtje kryesisht në lidhje me kohëzgjatjen e trajnimit, që është paraparë të mbahet nga 2 orë në ditë. Kjo shihet si një kohë në thelb e pamjaftueshme që të arrihet kualiteti i kërkuar. Gjithashtu, Shkumbini kishte vërejtje edhe në përmbajtjen e kurrikulave.

Vigani e vuri në pah se projekti i STIKK Academy është tepër mbrapa me ekzekutim, dhe se STIKK ka obligime kontraktuale kundrejt donatorëve, bordi u dakordua që nuk kemi shumë kohë për ndërrime. Mentori mori përsipër që deri në fund të javës (18.03.2016) të jep komentet eventuale në kurrikula. Bordi është i mendimit që STIKK Academy duhet të fillojë sa më parë me kurrikulat ekzistuese, ndërsa në ndërkohë të punohet me Zyrën Ekzekutive dhe me Komitetin Këshilldhënës për modifikimin e të njëjtave gjatë punës. Gjithashtu do të rishikohen kufizat buxhetore për zgjatjen e orarit të mësimi. Në lidhje me përbërjen e Komitetit Këshilldhënës, u dhanë propozime për të ftuar edhe anëtarë të tjerë në këtë Komitet. U propozuan disa emra, me të cilët anëtarët morën përsipër t'i kontaktojnë dhe të marrin pëlqimin e tyre. Kompletimi i këtij Komiteti mbetet detyrë e Bordit në takimet e ardhshme pas marrjes së mendimit nga anëtarët e propozuar.

2. Diskutim rreth Draft-Planit të punës për vitin 2016

3. Diskutim rreth Kontratës së DE

Në këtë pikë të gjithë anëtarët prezentë u pajtuan që Drejtoreshës Ekzekutive Vjollca Çavolli t'i ofrohet rinovimi i kontratës edhe për 2 vite të tjera. Në pikën e vlerësimit të punës së saj të deritashme, në bazë të matricës së dërguar nga vetë DE, Bordi vendosi që mos hyjë në vlerësimin e pikëve veç e veç, duke pasë parasysh që nuk kemi informata për të gjitha pikët, dhe se nuk kemi indikatorë të caktuar më parë. Në lidhje me indikatorët e suksesit, Bordi harmonizoi indikatorët dhe treguesit e suksesit që do të përdoren në të ardhmen për vlerësimin e punës së DE. Ky dokument është pjesë përbërëse e këtij procesverballi. Bordi, duke marrë parasysh: rritjen e buxhetit të STIKK ndër vite, faktin që DE nuk ka pasë rritje të pagës për 5 vite me radhë vendosi të bëjë rritjen e rrogës së DE për 10% në krahasim me kontratën e kaluar.

Shkumbini dhe Dardani u obliguan që këtë ofertë së bashku me dokumentin për vlerësimin e punës së DE me indikatorë të harmonizuar t'ia prezantojnë Drejtoreshës Ekzekutive më datën 21.03.2016.

4. Të tjera

Gjatë diskutimeve, pati edhe propozime të tjera, të cilat mbetën si detyra për mbledhjet e ardhshme të Bordit:

- Kërkesa për zyrën ekzekutive për hartimin dhe shqyrtimin e procedurave të brendshme së bashku me Bordin;
- Shqyrtimi i detyrave të deleguara nga Bordi te Zyra Ekzekutive dhe marrja e disa prej tyre përsëri në përgjegjësi të Bordit;
- Krijimi i një mekanizmi administrativ për ndërrimin e anëtarëve të Bordit të cilët nuk vijnë në mbledhje për një kohë më të gjatë;
- Në këtë pikë, anëtarët u pajtuan që të aprovojnë planin e propozuar.

Mbledhja katërdhjetë e pesë: 12 Prill 2016 (e rregullt)

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e katërdhjetë e tretë (e jashtëzakonshme) mbajtur më 22 shkurt 2016;
2. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e katërdhjetë e katërt (e jashtëzakonshme) mbajtur më 15 Mars 2016;
3. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor (Janar-Mars) të STIKK;
4. Përzgjedhja e nënshkruesve financiar të STIKK;
5. Diskutim rreth hapave të ardhshëm të STIKK Education:
 - I. Procedura e Përzgjedhjes së Trajnerëve,
 - II. Komiteti Këshillëdhënës i STIKK Education;
6. Diskutim rreth Admission Committee të ICK, pas dorëheqjes së z. Brestovci;
7. Diskutim rreth çështjeve të mbetura nga mbledhja e kaluar:
 - I. Kërkesa për zyrën ekzekutive për hartimin dhe shqyrtimin e procedurave të brendshme së bashku me Bordin,
 - II. Shqyrtimi i detyrave të deleguara nga Bordi të Zyra Ekzekutive dhe marrja e disa prej tyre përsëri në përgjegjësi të Bordit,
 - III. Krijimi i një mekanizmi administrativ për ndërrimin e anëtarëve të Bordit të cilët nuk vijnë në mbledhje për një kohë më të gjatë;
8. Të ndryshme:
 - I. Organizimi i Mëngjesit me anëtarët,
 - II. Organizimi i BBQ me anëtarët e STIKK,
 - III. Temat e mundshme për KosICT'16.

Vendimet:

- Miratuan unanimisht Procesverbalin e mbledhjes së katërdhjetë e tretë të Bordit të STIKK;
- Miratuan unanimisht Procesverbalin e mbledhjes së katërdhjetë e katërt të Bordit të STIKK;
- Miratuan raportin tremujor Janar - Mars 2016, me një abstenim (z. Arben Ymeraga);
- Në mënyrë unanime votohen si nënshkrues financiar z. Mentor Sahiti dhe z. Vigan Budima;
- Vendoset që të ketë tender publik (i hapur) për kompani/individ për trajnimet e STIKK Education;
- Vendoset që Komiteti Këshillëdhënës të STIKK Education i delegohet : a) Të merr vendim nëse duhet të vazhdohet me trajnimet për TOT apo të barten mjetet dhe të shfrytëzohen për trajnimet në përgjithësi c) Përgatitja e TOR për trajnerët si dhe syllabusat e trajnimeve dhe kriteret e përzgjedhjes, procesin e përzgjedhjes dhe raportimit të gjithë procesit;
- Miratohen anëtarët e propozuar për të qene anëtar të Komitetit Këshillëdhënës, ndërsa kishte një abstenim (z. Arben Ymeraga), ndërsa anëtarët janë si ne vijim: z. Dardan Vokshi, z. Mentor Sahiti, z. Driton Hapciu, z. Astrit Desku, z. Ermal Sadiku, z. Alejtin Berisha, z. Bekim Kosumi, z. Naim Berisha ndërsa mbetet të kontaktohen z. Visar Jasiqi nga STIKK, ndërsa z. Fatos Maxhuni dhe z. Faton Berisha nga Anëtarët e Bordit;
- Miratuan me një abstenim (z. Arben Ymeraga), propozimin që z. Dardan Vokshi të jete kryesues i Komitetit Këshillëdhënës të STIKK Education;
- Në mënyrë unanime propozohet dhe votohet z. Vigan Budima për Admission Committee të ICK, pas dorëheqjes së z. Brestovci;
- Vendoset që të kontaktohet dhe të ftohet z. David King për mëngjesin e pare të anëtarëve;
- Z. Mentor Sahiti dhe z. Ermal Sadiku shprehen gatishmërinë e tyre për të qene sponsor të një takimi mëngjes me anëtarë;
- Vendoset që të organizohet BBQ me anëtarët;
- Vendoset që të ju dërgohet anëtarëve të Bordit lista e temave të mundshme për KosICT'16 për inputet shtese;
- Miratohet unanimisht që mbledhja vjetore të mbahet me datën 17 Mars.

Vazhdimi i mbledhjes katërdhjetë e pesë: 20 Prill 2016 (e rregull)**Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:**

1. Diskutim rreth çështjeve të mbetura nga mbledhja e kaluar:
 - I. Kërkesa për zyrën ekzekutive për hartimin dhe shqyrtimin e procedurave të brendshme së bashku me Bordin,
 - II. Shqyrtimi i detyrave të deleguara nga Bordi të Zyra Ekzekutive dhe marrja e disa prej tyre përsëri në përgjegjësi të Bordit,
 - III. Krijimi i një mekanizmi administrativ për ndërrimin e anëtarëve të Bordit të cilët nuk vijnë në mbledhje për një kohë më të gjatë;
2. Të ndryshme:
 - IV. Temat e mundshme për KosICT'16.

Vendimet:

- Ne mënyrë unanime aprovohet afati për dërgimin e komenteve për procedurat e brendshme të STIKK;
- Vendoset që themelimi i komisioneve ad-hock të aprovohet nga bordi i STIKK;
- Vendoset që zyra ekzekutive e STIKK të dërgoj profilin e anëtarësimeve të reja për aprovim tek Bordi i STIKK;
- Ne mënyrë unanime aprovohet korrigjimi i manuali i bordit për largimin e anëtarit të bordit;
- Pas diskutimeve vendoset që të ju dërgohet anëtareve të STIKK lista e temave të mundshme për KosICT'16 për votim;
- Vendoset që tema eSports të shkojë me automatizëm;
- Ne mënyrë unanime vendoset që të tërhiqen të gjitha delegimet e vendimmarrjes të bëra në mbledhjen e mbajtur më 12 Prill për Komitetin
- Këshillëdhënës të STIKK Education dhe të mbetet vetëm e drejta e propozimeve;
- Pas diskutimeve mirëtohet vendimi që të mos merret asnjë veprim lidhur me shkarkimin e z. Altin Ukshini;
- Në mënyrë unanime vendoset që të mos dërgohet kërkesa tek ICK me 4 vota kundër dhe dy abstenime (z. Vigan Budima dhe z. Arben Ymeraga);
- Pas diskutimeve vendoset që IT DAY të organizohet serish në Prizren, të enjten e fundit të muajit Qershor.

Mbledhja katërdhjetë e gjashtë: 14 Shtator 2016 (e rregullt)

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e katërdhjetë e pestë mbajtur më 12 Prill 2016;
2. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit të vazhdimit të mbledhjes së katërdhjetë e pestë mbajtur më 20 Prill 2016;
3. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tre-mujor (Prill- Qershor) të STIKK;
4. Diskutimi i propozimeve të anetareve të bordit për procedurat në STIKK;
5. Raportim dhe diskutim për STIKK Education;
6. Të ndryshme:
 - I. KosICT'16,
 - II. Gjendja financiare e STIKK,
 - III. B2B Udhëtimet.

Vendimet:

- Miratuan unanimitet Procesverbalin e mbledhjes së katërdhjetë e pestë të Bordit të STIKK;
- Miratuan unanimitet Procesverbalin e vazhdimit të mbledhjes së katërdhjetë e pestë të Bordit të STIKK;
- Miratuan raportin tremujor Prill - Qershor 2016;
- Vendoset që në fillim të muajit Tetor të organizohet mbledhja e jashtëzakonshme për Konferencën KosICT.

Mbledhja katërdhjetë e shtatë: 7 Dhjetor 2016 (e rregullt)

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan gjatë kësaj mbledhjeje:

- 9.** Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e katërdhjetë e gjashtë, mbajtur më 14 Shtator 2016;
- 10.** Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor (Korrik-Shtator) të STIKK;
- 11.** E ardhmja e STIKK-ut;
- 12.** Të ndryshme.

Vendimet:

- Miratohet unanimitisht Procesverbal i mbledhjes së katërdhjetë e gjashtë të Bordit të STIKK;
- Miratohet raporti tremujor Korrik-Shtator 2016;
- Aprovohen të gjitha propozimet e bëra nga znj. Vjollca Çavolli;
- Z. Leutrim Blakaj dhe z. Mentor Sahiti, së bashku me z. Bardh Kadiu të përgatisin një propozim për pako të re të anëtareve;
- Të organizohet mbledhja e jashtëzakonshme e bordit më 10 Janar 2017;
- Aprovohet të hyjë në funksion skema e pagesës së komisionit;
- Miratohet unanimitisht që mbledhja vjetore e Kuvendit të mbahet në javën e parë të Shkurtit 2017.